



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 59 , Datë 24 / 07 / 2017

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr. Regj.23, datë 18.02.2016, të M. H, kundër Drejtores së Qendrës Spitalore “Xhafer Kongoli”, Elbasan, me objekt pretendimin e diskriminimit për shkak të “racës¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

M. H ka qenë në marrëdhënie pune prej 16 vitesh, si sanitare, në Pavionin e Pediatriisë, pranë Spitalit Rajonal Elbasan. Ankuesja shprehet se ka punuar me përkushtim dhe se ka zbatuar me përpikëmeri çdo urdhër të eprorit të saj. Ajo është transferuar² nga Pavioni i Pediatriisë në atë të Kardiologjisë. Më pas, i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës pa asnjë shkak, sipas ankuses, dhe pa marrë në konsideratë faktin se ajo është e divorcuar dhe ka dy fëmijë në ngarkim.

Ankuesja kërkon nga Komisioneri të konstatojë diskriminimin ndaj saj nga ana e drejtueses së Qendrës Spitalore “Xh.Kongoli”, Elbasan dhe të bëjë rikthimin e saj në punë.

¹ Ankuesja shprehet se i përket komunitetit egjiptian.

² Në formularin e ankesës së bërë pranë Komisionerit, nuk janë specifikuar periudhat kohore.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, **racën**, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.241/1 prot, datë 07.03.2016 u njoftua dhe ju kërkua informacion Qendrës Spitalore “Xh. Kongoli”, Elbasan, lidhur me pretendimin e ngritur nga znj. H.

Me shkresën me nr.469/1 prot, datë 31.03.2016, Qendra Spitalore “Xh. Kongoli”, Elbasan, informon Komisionerin se: “*Struktura Analitike e Shërbimit Spitalor Elbasan për vitin 2015 ka 117 sanitare, për vitin 2016 ka 65 sanitare. Kriteret për largimin e 52 sanitareve janë përcaktuar në shkresën e Ministrisë të Shëndetësisë, të pasqyruar në Udhëzimin nxjerrë nga Drejtoria e Spitalit Elbasan, për shqyrtimin e dosjeve të personelit. Komisioni i ngritur për çdo shërbim, me vendim nr.3, datë 20.01.2016, pasi shqyrtoi dosjet dhe performancat, caktoi personat që do të largoheshin. Me datë 29.01.2016 u thirrën nga ana e Komisionit të gjithë punonjësit që do të largoheshin për t’iu komunikuar “Përfundimin e marrëdhënieve të punës”. Ndër to ishte edhe znj.H, e cila nuk pranoi të firmoste shkresën e njoftimit të largimit nga puna. Për këtë fakt është mbajtur process-verbal nga ana e Komisionit.*

Sa i takon transferimit të znj.Hamzai nga Shërbimi i Pediatrisë në Shërbimin e Sëmundjeve të Brendshme (Kardiologji), është bërë për arsye të organizimit të brendshëm që bëhet sipas nevojave të shërbimeve”.

Nga ana e Spitalit Elbasan theksohet fakti se nisur nga parimi për të ndihmuar në sistemimin e znj.H pas largimit të saj nga puna, është biseduar me Drejtorinë e Zyrës Rajonale të Punësimit, Drejtorin, për ndërmjetësim punësimi.

2. Në vijim të procedurës për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, me datë 08.04.2016³, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim pranë Drejtorisë Qendrore Spitalore “Xh. Kongoli”, Elbasan.

Grupi i inspektimit të Komisionerit u takua me Drejtoreshen e kësaj Qendre Spitalore dhe Specialistin e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënive me Publikun, të cilat informuan se shkak i vetëm i largimit nga puna të ankueses është bërë Ristrukturimi Analitike e Shërbimit Spitalor Elbasan, si pasojë e të cilit janë larguar nga puna 52 sanitare, nga të cilat vetëm 2 të komunitetit rom e egjiptian. Aktualisht janë në punë 65 sanitare, nga të cilat 4 prej tyre të komunitetit rom e egjiptian, pra raca nuk ka qenë kriter për largimin e tyre nga puna. Gjatë inspektimit u mor dokumentacioni i cili fakton si kriteret që kanë shërbyer për vlerësimin e faktit se cilat sanitare duhet të largoheshin nga puna, (kriteri i arsimit, performancës dhe disiplinës në punë).

3. Në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, sipas nenit 33, pika 8, me datë 02.06.2016, Komisioneri realizoi një seancë dëgjimore mes palëve.⁴

Seanca u zhvillua me praninë e të dyja palëve. Ankuesja u qëndroi pretendimeve të saj të bëra prezent në formularin e ankesës, si dhe parashtrori pretendimin se nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan janë rimarrë në punë sanitaret e larguara njëherësh me atë: Sh. C, S. Z, S. K, V. M, P. Sh

Spitali Rajonal Elbasan, u përfaqësua nga B. D, me pozicionin Specialiste e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënive me Publikun, e cila theksoi faktin, se e gjithë procedura e ndjekur për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të ristrukturimit⁵ është kryer në përputhje të plotë me zbatimin e udhëzimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe si rrjedhojë nuk ka ardhur si pasojë e diskriminimit siç pretendon ankuesja. Nga ana e Institucionit të tyre është biseduar dhe me Zyrën e Punësimit Elbasan, në mënyrë që të trajtoheshin me përparësi rastet e punonjësve të larguara si rezultat i ristrukturimit. Lidhur me rikthimin në punë të punonjësve të larguara, znj.D informoi se janë rimarrë në punë vetëm dy nga emrat e cituar, dhe jo në pozicionin e sanitares, sepse numri i sanitareve nuk është rritur, por janë emëruar në pozicionin e lulishtares dhe atë të punonjësës hoteliere.

4. Me shkresën me nr.638 prot., datë 14.06.2016 iu kërkua informacion shtesë Spitalit Rajonal Elbasan, lidhur me pretendimin e ankueses gjatë seancës dëgjimore.

Me shkresën me nr.1041/1 prot., datë 30.06.2016 Spitali Rajonal Elbasan informon Komisionerin se: *“Numri i sanitareve të këtij Spitali aktualisht është i njëjtë me atë të strukturës së datës 18.01.2016, pra 65 sanitare. Ky numër nuk ka ndryshuar. Nga lista e emrave që ka parashtruar ankuesja në seancën dëgjimore, vetëm dy nga punonjëset janë rimarrë në punë; por jo në pozicionin e sanitares,*

³ Në zbatim të Urdhërit nr.56, datë 01.04.2016, të Komisionerit.

⁴ Në zbatim të shkresës me nr.237/4 prot, datë 27.05.2016, të Komisionerit.

⁵ Suprimim dhe shkurtim i vendit të punës.

(pasi nuk kishte vende të lira) por specifikisht: F.D në pozicionin e lulishtares dhe P.SH në pozicionin e punonjësesh hoteliere”.

Duke qenë se Ministria e Shëndetësisë është Institucioni që ka udhëzuar dhe Qendrën Spitalore “Xh.Kongoli”, Elbasan për zbatimin e strukturës së re, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

5. me shkresën me nr.241/3 prot., datë 08.07.2016 i ka kërkuar informacion Ministrisë së Shëndetësisë, lidhur me faktin nëse kriteri i arsimit ka qenë i detyruar të merrej në vlerësim dhe për punonjësit sanitarë. (si dhe arsyetimin që ka përfshirë këtë kriter).
6. Duke qenë se kriteri i arsimit në shumicën dërrmuese të rasteve të largimit nga puna kishte qenë vendimtar, Komisioneri vlerësoi si të domosdoshëm marrjen e informacionit nga Ministria e Shëndetësisë, si Institucioni që ka udhëzuar Spitalin për zbatimin e strukturës së re.

Lidhur me këtë fakt, me Vendimin nr.119, datë 15.07.2016, Komisioneri, vendosi pezullimin e procedimit administrativ⁶ për ankesën e M. H, me qëllim marrjen e të gjithë informacionit të nevojshëm, për një gjykim sa më të drejtë, objektiv dhe të paanshëm të rastit në fjalë.

7. Me shkresën me nr.612/2 prot., datë 06.07.2017 Komisioneri i ka kërkuar informacion shtesë Qendrës Spitalore “Xh.Kongoli”, Elbasan lidhur me tabelën e pikaverazhit për të gjitha punonjëset sanitare të spitalit (117 punonjëse), si dhe kopje të vendimeve të largimit nga puna për të gjitha punonjëset sanitare (52 punonjëset) që propozoheshin për t’u larguar nga puna në zbatim të shkresës nr.261 prot., datë 18.01.2016 të Ministrit të Shëndetësisë.

Për sa më lart, Qendra Spitalore “Xh.Kongoli”, Elbasan, me shkresën me nr.1296/1 prot., datë 11.07.2017 informon Komisionerin se M. H është punësuar si sanitare me kontratë nga të ardhurat dytësore, që nga data 10.11.2016.

8. Me shkresën me nr.612/4 prot., datë 20.07.2017 Komisioneri ka kërkuar saktësim informacioni dhe plotësim dokumentacioni lidhur me çështjen në fjalë.

Me shkresën 724 prot., datë 24.07.2017 ankuesja tërheq pretendimin për diskriminim nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan, pasi ajo e konsideron të zgjidhur problemin e saj, pas ndërhyrjes dhe ndërmjetësimit të Komisionerit.

Për sa më sipër, gjatë procesit të hetimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti ankues dhe pala kundrejt së cilës drejtohej ankimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi :

⁶ Në zbatim të nenit 85, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

Referuar shkresës me nr.1296/1 prot., datë 11.07.2017 të Qendrës Spitalore “Xh.Kongoli”, Elbasan, si dhe shkresës me nr.724 prot., datë 24.07.2017 të M.H, e konsiderojmë të zgjidhur problemin e ankueses, pas ndërhyrjes dhe ndërmjetësimit të Komisionerit.

Reagimi zyrtar nga ana e Qendrës Spitalore “Xh.Kongoli”, Elbasan, në favor të subjektit ankues ka qenë konkret pas ndërhyrjes dhe ndërmjetësimit të Komisionerit, pasi M. H është punësuar si sanitare që nga data 10.11.2016.

Neni 33, pika 9 e LMD-së⁷ parashikon se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa”.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet: 1, 2, 7, nenin 32, pika 1, germa c), nenin 33, pikat 9 dhe 10, të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe nenin 94, pika⁸, të Kodit të Procedurave Administrative,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Ndërprejjen e procedurave hetimore dhe pushimin e çështjes, pasi konsiderohet se pas ndërhyrjes dhe ndërmjetësimit të Komisionerit është arritur qëllimi i ankueses lidhur me punësimin e saj, në pozicionin e saj të mëparshëm si sanitare, pranë Qendrës Spitalore “Xh.Kongoli”, Elbasan.
2. Në përfundim të kontratës së punës me ankuesen, në muajin Dhjetor 2017, Qendra Spitalore “Xh.Kongoli”, Elbasan rekomandohet ta rinovojë atë, duke pasur parasysh gjendjen e vështirë ekonomike të saj si dhe faktin që ajo është dhe kryefamiljare; si dhe të njoftojë Komisionerin lidhur me masat e ndërmarra për punësimin e M. H.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

⁷ Shkurtesë për: “Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi”

⁸ Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar, nëse pala që e ka paraqitur atë tërhiqet”.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

Fusha: Punesim

Shkaku: Raca

Lloji i vendimit: Arritje efektiviteti